



Efienca e buxhetit të Bashkisë Vlorë (Viti 2021)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2021

Studimi ka për qëllim të analizojë efiençën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2021, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	% mbi totalin e të ardhurave 2021
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	548,229	23 %
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	412,452	17 %
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	1,103,071	47 %
Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj)	307,621	13 %
TOTALI	2,371,373	100 %

Burimi: Bashkia Vlorë (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Vlorë 2021



Burimi: Bashkia Vlorë (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Vlorë për vitin fiskal 2021

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2021. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale 2021

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	% mbi totalin e të ardhurave 2021
Shpenzime Paga+Sig.Shoq (601)	902,850	38 %
Shpenzime Operative (602)	928,605	39 %
Subvencione (603)	45,780	2 %
Investime (231)	368,473	16 %
Të tjera (166,651, 606, 609)	125,665	5 %
TOTALI	2,371,373	100 %


Burimi: Bashkia Vlorë (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet si raport mbi të ardhurat totale 2021



Burimi: Bashkia Vlorë (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale 2021



Burimi: Bashkia Vlorë (llogaritje EIC)